



I Colin Rowe of Peter House, Oxford Street, Manchester M1 5AN United Kingdom, a duly authorised notary public CERTIFY that the signature on the attached document is the authentic signature of Aljoša Jenko, a Director of HTTPOOL HOLDINGS UK LIMITED, company number 10375627.

SIGNED and sealed at Manchester, United Kingdom on 19 August 2022

Notary Public England and Wales

Protocol number 45822

COLIN ROWE NOTARY PUBLIC  
England & Wales  
Peter House, Oxford Street  
Manchester M1 5AN United Kingdom  
+44 (0) 777 444 0024  
[notary@colinrowe.co.uk](mailto:notary@colinrowe.co.uk)



**APOSTILLE**

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

**1. Country:** United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland

Pays / País:

**This public document**

Le présent acte public / El presente documento público

**2. Has been signed by**a été signé par  
ha sido firmado por

Colin Rowe

**3. Acting in the capacity of**

Notary Public

agissant en qualité de  
quien actúa en calidad de**4. Bears the seal / stamp of**

The Said Notary Public

est revêtu du sceau / timbre de  
y está revestido del sello / timbre de**Certified**

Attesté / Certificado

**5. at** London **6. the** 30 August 2022

á / en le / el día

**7. by** Her Majesty's Principal Secretary of State for  
par / por Foreign, Commonwealth and Development Affairs**8. Number** APO-MA5O-68XI-W701-VVL6

sous no / bajo el numero

**9. Seal / stamp**  
Sceau / timbre  
Sello / timbre**10. Signature** P. Blay  
Signature  
Firma

This Apostille is not to be used in the UK and only confirms the authenticity of the signature, seal or stamp on the attached UK public document. It does not confirm the authenticity of the underlying document. Apostilles attached to documents that have been photocopied and certified in the UK confirm the signature of the UK official who conducted the certification only. It does not authenticate either the signature on the original document or the contents of the original document in any way.

If this document is to be used in a country not party to the Hague Convention of the 5th of October 1961, it should be presented to the consular section of the mission representing that country

To verify this apostille go to [www.verifyapostille.service.gov.uk](http://www.verifyapostille.service.gov.uk)

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË  
Htpool SHPK**

**THEMELIMI**

**Neni 1  
Ortaku themelues**

- 1.1 Shoqëria Htpool SHPK themelohet nga Ortaku i Vetëm **shoqeria HTTPOOL HOLDINGS UK LIMITED** private limited company, me Numer Regjistrimi **No. 10375627**, me adrese ne Fifth Floor, 55 King Street, Manchester, United Kingdom M2 4LQ.

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2  
Emërtimi**

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është **Htpool**.

**Neni 3  
Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4  
Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

**Neni 5  
Kohëzgjatja e veprimtarisë**

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është per nje afat te papercaktuar.

**Neni 6**  
**Selia**

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: **Njesia administrative Nr. 2, Rr. Themistokli Germanji, Pallati Pegaso, Kati 1, Ap. 2 – Tirane, Shqipëri.**
- 6.2 Administratori i shoqërise mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të crregjistroje ato ekzistuese sipas ligjeve ne fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashte saj me vendim te Administratorit te shoqërisë.

**Neni 7**  
**Emblema. Vula**

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemët dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnë emblemën dhe vulën e saj.

**Neni 8**  
**Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: **Ofrimi i shërbimeve të përfaqësimit mediatik, marketingut dixhital, strategjisë kreative, ekzekutimit të fushatës në mediat sociale dhe biznese të tjera të lidhura sipas gjykimit të menaxhmentit.**
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 9**  
**Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **600'000** (gjashtëqind mijë) Leke.
- 9.2 Ortaku i Vetëm zoteron 1 (një) kuote, e cila eshte e barabarte me vleren e kapitalit.
- 9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

**Neni 10**  
**Transferimi i kuotave. Kufizimet.**

- 10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Ortakut të Vetëm.

**Neni 11**  
**Rritja e kapitalit**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 12**  
**Zvogëlimi i kapitalit**

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpëra marrjes së vendimit nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë. Eksperi kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin ortakut të vetëm raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë.

**ORGANET E SHOQËRISË**

**Neni 13**  
**Vendimet e ortakut të vetëm**

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm i saj.
- 13.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht:
- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
  - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe percaktimin e shpërbimit per ta;

Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe percaktimin e shpërblimit per ta;  
Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;  
Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;  
Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.

#### **Neni 14** **Administrimi**

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.
- 14.3 Administratori i shoqërisë eshte **Z. Rade Tričković**, shtetas serb, lindur më 20.11.1975, në Beograd, banuese në Stari Grad, Beograd, Knez Miletina 009, mbajtës i Pasaportës Nr. 014617583.
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:  
Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;  
Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëni me të tretët personalisht ose me përfaqësim;  
Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;  
Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;  
Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;  
Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitacione apo entitetë publike ose private;  
Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;  
Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;  
Të vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë;  
Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;  
Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për biznesin e shoqërisë në Shqipëri.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për **5 vjet** me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 15**  
**Viti finanziar**

- 15.1 Viti finanziar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë finanziar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

**Neni 16**  
**Bilanci. Kontabiliteti.**

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekoje pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 17**  
**Te Ardhurat. Dividendi**

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund t'i kalojne ortakut te vetem.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortaku do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

**Neni 18**  
**Likuidimi**

18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Ortakut të Vetëm.

18.2 Me vendimin e Ortakut të Vetëm caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.

18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

**Neni 19  
Mosmarrëveshjet**


19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

**Neni 20  
Klauzolë mbyllëse**

20.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, datë 19.08.2011

**Ortaku i Vetëm  
HTTPPOOL HOLDINGS UK LIMITED  
Perfaqesuar nga Z. Aljoša Jenko**



Unë Colin Rowe i Peter House, Oxford Street, Manchester M1 5AN, Mbretëria e Bashkuar, noter publik i autorizuar siç duhet, VËRTETOJ se nënshkrimi në dokumentin e bashkangjitur është nënshkrimi autentik i Aljosa Jenko, Drejtor i HTTPPOOL HOLDINGS UK LIMITED, numër shoqerie 10375627.

NËNSHKRUAR dhe vulosur në Manchester, Mbretëria e Bashkuar më 19 gusht 2022

Noter Publik Angli & Uells

Numri potokollit 45822

COLIN ROWE NOTER PUBLIK  
Angli & Uells  
Peter House, Oxford Street  
Manchester M1 SAN Mbretëria e Bashkuar  
+44 (0) 777 444 0024  
notary@mlinrowe.co.uk



<b>Apostile</b> (Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)			
1. Vendi:			
Pays/ País:			
Mbreteria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut			
Ky dokument publik			
Le présent acte publik / El presente documento público			
2. Është nënshkruar nga			
a été signé par			
ha sido firmado por			
Colin Rowe			
3. Duke vepruar në cilësinë e			
agissant en qualité de			
quien actua en calidad de			
Noter Publik			
4. Mban vulën/ pullën e			
est revetu du sceau/ timbre de			
y está revestido del sello/ timbre de			
Noteri Publik i lartpërmendur			
Vërteton			
Attesté / Certificado			
5. në			
á / en			
Londër			
6. më			
le / el dia			
30 Gusht 2022			
7. nga			
Sekretari kryesor i Shtetit i Madhërisë së Saj			
për Punët e Jashtme dhe të Komonuelthit			
Par / por			
8. Numri			
sous no/ bajo el numero AP0-MA5O-68XI-W701-VVL6			
9. Vula/pulla			
Sceau / timbre			
Sello / timbre			
10. Nënshkrimi			
Signature			
Firma			
P.Blay			

Kjo Apostile nuk është për tu përdorur në Mbreterinë e Bashkuar dhe vetëm konfirmon autenticitetin e firmës, vullës apo pullës bashkangjitur dokumentit publik të Mbreterisë së Bashkuar. Nuk konfirmon autenticitetin e dokumentit themelor. Apostilet bashkangjitur dokumenteve që janë fotokopjuar dhe certifikuar në Mbreterinë e Bashkuar konfirmojnë nënshkrimin e zyrtarit të Britanisë së Madhe që vetëm përcollti certifikatën. Në asnjë mënyrë nuk vërteton as firmën e dokumentit original as përbajtjen e dokumentit original.

Nëse ky dokument do të përdoret në një vend që nuk bën pjesë në Konventën e Hagës të 5 tetor 1961, ai duhet të paraqitet në seksionin konsullor të misionit që përfaqëson atë vend. Për të verifikuar këtë Apostile shkoni në [www.verifyapostille.service.gov.uk](http://www.verifyapostille.service.gov.uk)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ALKET Z. MANÇKA**



**DATE 07/09/2022  
NR REP 5164**

**VËRTETIM PËRKTHIMI**

Sot, më datë 07/09/2022, para meje Noter ALKET Z. MANÇKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6, u paraqit personalisht:

**PËRKTHYES:**

Thodhori Kamberi, atësia Kristostom, amësia Amalina, shtetas Shqiptar, lindur në Athinë, Greqi (GRC) dhe banues në TIRANË, me adresë Pjetër Budi; Nd. 19; H. 19; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 18/06/1991, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035071118 dhe nr. personal J10618107T.

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëruar rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

ALKET Z. MANÇKA

